



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **19.04.2022**, me fillim në ora **10.00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Defrim Kafexhiu**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Projekt Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ne Rahovec (QKMF);
3. Shqyrtimi i Projekt Planit Komunal për Integritet 2022 – 2026;
4. Raporti vjetor i Punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2021;
5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2021 dhe vitin 2022;
6. Shqyrtimi i Raportit Financiar Janar – Mars 2022;
7. Shqyrtimi i Propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe ri emërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve ne Komunën Rahovecit;
8. Shqyrtimi i Propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin dhe ri emërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve ne Komunën e Rahovecit;
9. Shqyrtimi i Propozim vendimit për caktimin e lokacionit për hapësira për biznese;
10. Shqyrtimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër te pronave komunale për Bujqësi;
11. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies ne shfrytëzim të pronës se paluajtshme te Komunës P – 00054-0, 00265-0, 00489-0, 02909-0, 03015-0, 03016-0, 00251-0;
12. Shqyrtimi i propozim vendimit për dhënien ne shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për Blegtori;

13. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 02302-0 dhe P – 00250-0;

14. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P – 71513005-02756-0 në Zonën Kadastrale në Krushe të Madhe;

15. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P – 71510033-00527-1 në Zonën Kadastrale në Xërxë;

16. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm P – 71510033-00527-2 në Zonën Kadastrale në Xërxë;

17. Të ndryshme.

Kryesuesi – Për këtë mbledhje me miratimin e anëtareve të KPF-së, e kemi edhe një pikë shtesë : Raporti i vlerësimit të pronës së paluajtshme komunale, ku për pronën në fjalë komisioni që u formua në seancën e kaluar të SHL-Kosova. A jeni për vendosjen e kësaj pike shtesë në rendin e ditës.

Burim Krasniqi – Meqenëse është të plotësimi i rendit të ditës, e thash edhe para seancës do të ishte mirë me i paraparë edhe dy komitete jo obligative, komiteti për shëndetësi dhe komiteti për arsim. Kështu që për procedura tjera për seancë, administrata duhet me përgatitë rreth procedurave tjera që kur të vjen si propozim vendim me nxjerr në asamble komunale. Pra me këto 3 pika e rrumbullakojmë me 20 pika rendin e ditës së seancës së radhës.

Kryesuesi – E qesim në votim pikën shtesë në rendin e ditës. Kështu që me shumicë të votave aprovohet edhe pika e 18-të e rendit të ditës. Po ashtu kemi edhe propozimin tjetër për formimin e dy komiteve jo obligative. E qesim në votim propozimin e Burim Krasniqit për formimin e komitetit jo obligativ për arsim. Me shumicë të votave aprovohet edhe pika e 19-të e rendit të ditës. Vazhdojmë edhe me propozimin tjetër të z. Burim Krasniqit për formimin e komitetit jo obligativ për shëndetësi. Konstatoj se me shumicë të votave aprovohet edhe propozimi tjetër i Burim Krasniqit, kështu që aprovohet edhe pika e 20-të e rendit të ditës.

Tani e qesim në votim rendin e ditës së bashku me pikat shtesë. Konstatoj se me shumicë të votave miratohet edhe rendi i ditës për mbledhjen e KPF-së. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

Besë Bytyqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolege këshilltarë. Kërkoj nga zyra e Kuvendit dhe nga zyrtarja për lektorim e Komunës që materiali që na sjellët në kuvend të lekturohet në mënyrë të denjë pasi ka gabime të tmerrshme gramatikore dhe mbi 70% e shkronjës ë nuk ekzistojnë. Kështu që kërkoj të përmirësohet jo vetëm procesverbalit por edhe materiali që po na vjen në Kuvend por edhe në KPF.

Kryesuesi – E qesim në votim shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Atëherë me shumicë të votave miratohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Projekt Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec (QKMF).

Fatmir Iska – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtar të Komitetit për Politike dhe Financa, drejtor të drejtorive dhe gjithë të pranishmit. Para vetes e kemi statutin e qendrës kryesore të mjekësisë familjare në Rahovec, që i ka kaluar të gjitha procedurat sa i takon konsultimeve publike, që është një statut që buron edhe prej udhëzimit administrativ dhe që është statut unik në të gjitha komunat e Kosovës, që mund të ketë

ndërhyrje eventuale gjuhësore , përndryshe sipas udhëzimit administrativ që janë te parapara nuk besoj që mund te ndryshohen. Kështu që me hyrjen ne fuqi te këtij statuti shfuqizohet statuti i vitit 2014. Pra për me tepër do te diskutojmë edhe ne mbledhje te kuvendit.

Burim Krasniqi – Unë po konsideroj që për mbledhje te kuvendit, statuti duhet me u plotësua fillimisht me shkurtesat sepse jo te gjithë ne i dimë domethënien e shkurtesës, pra këto shkurtesa duhet te vendosen ne fillim që me pas mundësi me dit secila shkurtesë se çka paraqet. Pastaj e dyta nëse nuk është ne kundërshtim me ligjin, po konsideroj që te neni 6 te veprimtaria, duhet me konsultu edhe me profesionistë te fushës , pasi jam me profesion inxhinier dhe nuk po mundem me potencua saktësisht, që me i paraparë edhe ambulantet specialiste që munden me punu ne kuadër te QKMF-së, pasi kemi specialist te fushës që munden edhe me operu ne QKMF në Rahovec. Po ashtu edhe diçka që po kërkojmë me u shoqërua si statut ne seancë te kuvendit që me pas edhe një rezyme te zhvillimeve që kanë ndodhë ne diskutime publike për shkak te procedurës që duhet me kaluar deri sa te vjen ne kuvend, që me pas një histori te shkurtër se çka ka ndodh gjate kësaj historie, përveç asaj që prezantoj ne KPF nënkryetari i komunës.

Kryesuesi –Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e dytë te rendit te ditës.

Konstatohet se me shumicë te votave aprovohet edhe pika e dytë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e tretë te rendit te ditës:

3. Shqyrtimi i Projekt Planit Komunal për Integritet 2022-2026.

Arben Gashi – Përhëndetje për te gjithë. Projekt plani komunal për Integritet 2022-2026 është plan unifikues nga Ministria Administrimit te Pushtetit Lokal që ju është dërguar komunave. Plani është 4 vjeçar dhe pas dërgimit te këtij plani te kryetari i komunës dhe me pastaj kryetari i komunës ka formuar grupin punues prej 18 anëtareve, ku janë respektuar te gjithë procedurat ligjore dhe ky plan ka kalu ku është mbajtur njoftimi publik prej 02.02.2022-04.03.2022 dhe është mbajtur konsultimi publik me qytetare me datë 16.02.2022. Ky projekt plan synon te kontribuoj ne ndërtimin e një administrate komunale profesionale te modernizuar dhe te qëndrueshme me qellim te ngritjes se mirëqenies sociale dhe ofrimit te shërbimeve për te gjithë qytetaret te Komunës e Rahovecit. Projekt Plani është i harmonizuar me strategjinë e Kosovës kundër korrupsionit dhe planin e veprimit kundër korrupsionit. Ky projekt plan i mundëson identifikimin e rreziqeve te korrupsionit ne fusha te ndryshme te komunës, vlerësimin e çfarëdo lloj rreziku që mundëson dhe paraqet ne shfaqjen e korrupsionit ne komunë dhe përcaktimin e masave parandaluese ose eliminimin e rreziqeve te korrupsionit dhe sjelljeve te tjera profesionale. Ky plan ka kaluar neper disa faza , ku faza e parë e këtij plani është faza përgatitore ku kryetari e ka caktuar grupin punues dhe unë jam si kryesues i grupit punues. Faza e dytë është faza e vlerësimit te rreziqeve te integritetit, ku grupi punues pas takimeve është grumbulluar dhe është mbledhur legjislacioni dhe aktet nënligjore për punimin e këtij plani. Faza e tretë është faza e përcaktimit te prioritetit, propozimi i masës për përmirësimin e integritetit ku janë përcaktuar masat për parandalimin dhe eliminimeve te rreziqeve dhe përgjegjësit për zbatim. Faza e katërt është e monitorimit dhe raportimit te këtij plani, ku pas kalimit te këtij plani komunal për integritet nga kuvendi, kryetari i komunës do ta cakton një koordinator ku do te raportoj për zyrën e kryetarit dhe do te raportoj ne kuvend. Fushat e rrezikut që janë te parapara ne këtë plan janë fushat e përgjithshme te rrezikut ku hyjnë politika e burimeve njerëzore, sjellja etike profesionale te punësuarve brenda administratës, planifikimi dhe menaxhimi i financave, komunikimi dhe informimi, ruajtja dhe siguria e te dhënave te dokumentacionit. Ndërsa fushat specifike janë auditimi i brendshëm, prokurimi publik, zhvillimi ekonomik lokal, planifikimi urban rural arsime publik, shëndetësia dhe mirëqenia sociale shërbimet publike, komunikimi me palë te jashtme siç janë gjeodezia kadastra prona kultura rinia sporti, bujqësia pylltaria dhe zhvillimi rural. Kështu që nëse ka dikush ndonjë pyetje atëherë jemi këtu për të ju përgjigjur.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar për këtë pikë, e qesim ne votim. Me shumicë te votave aprovohet edhe pika e tretë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e katërt te rendit te ditës:

4. Raporti vjetori Punës se Komitetit të Auditimit për vitin 2021.

Kryesuesi - Këtë raport do te duhej që ta prezantoj kryesuesi te Komitetit mirëpo mungon tani, kështu që shpresojmë që për seancën e kuvendit te jetë prezent që ta bëj prezantimin.

Burim Krasniqi – Meqenëse personi nuk fjalë nuk është i pranishëm, atëherë mendoj se kjo duhet me u shtye për ne seancën e radhës, kështu që e jap si rekomandim që pika e katërt e rendit te ditës te shtyhet për ne seancën e radhës dhe te jetë personi përgjegjës këtu sepse KPF-ja e bën edhe filtrin parapërgatitor për seancë te kuvendit dhe nuk ka logjike me ardhë në seancë kjo pikë pa kaluar ne KPF për diskutim, aq sa dimë dhe aq sa mundemi, kështu që me pas një prezantim edhe prej zyrtarit përgjegjës. Pra meqenëse nuk është prezent atëherë po konsideroj që nuk është shume rëndësishme pasi kështu është vlerësuar prej tij atëherë duhet te kaloj për ne seancën e radhës që me pas mundësi me diskutue.

Kryesuesi – E qesim ne votim propozimin e Burim Krasniqit për largimin e pikës se katërt nga rendi i ditës. Me 3 vota për, 1 abstenim dhe 1 kundër, atëherë kjo pikë e rendit te ditës vazhdon te mbetet pjesë e rendit te ditës për seancën e rregullt. Kalojmë ne pikën e pestë te rendit te ditës:

5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2021 ne vitin 2022.

Afrim Limani – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetar dhe ju anëtar te KPF-së. Fillimisht ju kërkoj falje pasi jemi te detyruar që edhe njëherë këtë pikë te rendit te ditës ta qesim ne kuvend. Arsyeja qëndron ne faktin se i gjithë ky proces është vonuar për dy muaj për shkak te mosbarazimit te dy departamenteve te ministrisë se financave pra departamentit te thesarit dhe departamentit te buxhetit. Pra arsyeja qëndron ne faktin se 3 projektet te cilat i kemi bartur ne investime kapitale, realisht sipas udhëzimit te tyre këto projekte nuk guxojnë te kalojnë ne investime kapitale dhe atëherë duhet te kalojnë ne mallra dhe shërbime. Vlera e këtyre ndryshimeve është 120,000 euro edhe këto projekte janë intervenime emergjence ne infrastrukturë, furnizim me gypa PVC dhe hartimi i projekteve te ndryshme. Realisht këto projekte janë ne rezerva prej vitit 2022 dhe ne vitin 2021 nuk kanë qenë rezerva dhe kjo ka qenë arsyeja pasi që ne që kemi propozuar për bartjen, konsideroj që gjithçka ka qenë ne rregull mirëpo kemi marr rekomandimin që këto nuk guxojnë te kalojnë ne investime kapitale pasi që këto projekte gjinden ne rezerva ne kuadër te vitit 2022 atëherë sipas ligjeve ne fuqi dhe rekomandimeve te tyre këto projekte i kemi bartur ne mallra dhe shërbime. Pra fjala është për 3 projekte ne kuadër te drejtorisë shërbimeve publike janë dy projekte dhe hartimi i projekteve është ne drejtorinë e urbanizmit. Këto projekte i kemi te propozuara që me i bartë ne mallra dhe shërbime ne kuadër te drejtorive përkatëse. Pra edhe njëherë jemi te detyruar që me rikthye këtë pike te rendit te ditës.

Burim Krasniqi – A janë te njëjtat mjete që i kemi bartur me herët apo janë mjete te reja apo veç ri programim i tyre.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim. Konstatoj se me shumicë te votave kalon për kuvend edhe pika e pestë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e gjashtë te rendit te ditës:

6. Shqyrtimi i Raportit Financiar Janar – Mars 2022.

Afrim Limani – Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur raportin 3 mujor financiar. Ky raport përbehet prej dy pjesëve kryesore pjesa e te hyrave dhe pjesa e realizimit te buxhetit. Të hyrat për 3 mujor ne total janë 255,331 euro dhe nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë te vitit te kaluar atëherë kemi rënie te te hyrave ne vlerë prej 26,155 pra fjala është për te hyrat e rregullta. Ndërsa gjrobat e gjykatave për këtë 3 mujor deri ne momentin kur e kam dorëzuar raportin nuk kemi pasur te hyra mirëpo ne ndërkohë pas dorëzimit te raportit atëherë na kanë arritur te hyrat nga gjrobat e gjykatave që ne total janë 14,700 euro,

gjohat trafikut 82,091, të hyrat nga pyjet janë 44,90 që ne total bëjnë 96,835 euro dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë kemi prapë një ndryshim negativ prej 6114 euro. Kështu që ju mund të bëni pyetje se pse këtë 3 muajor kemi zbritje dhe lirisht mund të ju them se ka ndikuar heqja e udhëzimit nga ana e kryeministrit për kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve dhe kjo ka reflektuar drejtpërdrejt te inkasimit të tatimit në pronë. Në faqe numër 5 kemi të prezantuar realizimin e të hyrave sipas kodeve ekonomike ku do të ju jap një përshkrim të gjithanshëm, pastaj në faqe 6 kemi të prezantuar realizimin e tatimit në pronë, mjetet e planifikuara të realizuara gjithmonë në bazë të raportit 3 muajor dhe në fund e kemi numrin e regjistrimeve reja dhe numrin e verifikimeve të reja. Në faqe 7 kemi të prezantuar shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike dhe në kuadër të programeve, ku në total shpenzimi i buxhetit është në shumen prej 3,565,544 euro që në përqindje i bien 23,48% që realisht trendi i shpenzimit të buxhetit është duke shkuar sipas trendit të mirë dhe besoj që deri në fund të vitit nuk do të rrezikohemi nga suficiti sepse këtë vitë e kemi edhe përgatitjen e kesh planit në baza mujore për dallim prej muajve të tjerë. Dhe krejt në fund në faqe 9,10,11,12 kemi të prezantuar shpenzimet në mënyrë analitike sipas kodeve ekonomike në kuadër të drejtorive dhe krejt në fund e kemi shpenzimin e buxhetit në kuadër të komunalivë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë nëse nuk ka dikush diçka sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe ri emërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në komunën e Rahovecit.

Albnor Mullabazi – I nderuar kryesues, nënkryetar, kolegë drejtor, anëtar të KPF-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të ligjit me nr.03L/40 për vetëqeverisje lokale të Kosovës, Kryetari i Komunës propozon formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve shesheve e lagjeve në komunën e Rahovecit. Ky komision do të përbëhet prej 5 anëtareve, ku 3 anëtar do të jenë nga kuvendi dhe 2 nga ekzekutivi.

8. Shqyrtimi i Propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave parqeve shesheve e lagjeve në Komunën e Rahovecit.

Albnor Mullabazi - Edhe në këtë komision do të përbëhet prej 5 anëtareve, ku 3 do të jenë nga kuvendi dhe 2 nga ekzekutivi.

Rumir Zhuniqi – Këto dy pika po i kalojmë për kuvend pasi aty bëhen propozimet, janë dy komisionet njeri për emërtime dhe tjetri për ankesa, kështu që në kuvend bëhen propozimet dhe i kalojmë direkt në kuvend.

Kryesuesi – Atëherë i qesim në votim. Konstatoj se me shumicë të votave kalojnë për kuvend dy pikat e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i Propozim vendimit për caktimin e lokacionit për hapësira për biznes.

Erhan Morina – i nderuar kryesues, nënkryetar, drejtor të drejtorive, anëtar të KPF-së. Para jush keni materialin që ka propozuar drejtoria për ekonomi zhvillim dhe turizëm të dy parcelave që janë pronë e komunës që gjinden në Krushe të Madhe dhe në të cilat parcela planifikohen të destinohen hapësira për biznese. Parcela me çertifikat kadastrale 010174-0 në zonën kadastrale në Krushe të Madhe me sipërfaqe 143,712 m². Po ashtu është edhe një parcelë tjetër e cila gjendet në këtë zonë në Krushe të Madhe me numra kadastral 02745-0 në zonë kadastrale në Krushe të Madhe në vendin e quajtur Rasa prom me sipërfaqe 331,960m². Këto dy parcela është planifikuar të destinohen hapësira për biznese në funksion të tërheqjes së investitorëve dhe krijimit të hapësirave për biznese që ofrojnë në komunën tonë. Andaj kërkojë nga Komiteti për Politikë dhe financa të votojnë këtë pikë të rendit të ditës për seancën e radhës.

Burim Krasniqi – Para se me votua ne seancën e kuvendit, meqenëse është zone te Drini ne Krushe të Madhe siç e shoh ne ortofoto, nuk e di a jeni konsultu me ministrinë e Mjedisit që a lejohet ndërtimi dhe sa kemi te drejtë te afrohemi shtratit te Drinit që i keni nda këto parcela. Pra mos po bimë ne konflikt me çështjen e mbrojtjes se ambientit apo te lumit . Po ashtu ne ortofoto shihen dy parcela atë punueshme, kështu a ka ndonjë kontest pronësor apo jemi ne rregull me to, që mos po ndërtojmë konflikt ne Krushe te Madhe me votimin tone ne asamble komunale. Do te ishte mire me na sjell këto dy informata.

Afrim Oruqi – Në pyetjen e kuvendarit ne lidhje me këto parcela, ka një vendim te kuvendit komunal te Rahovecit ne lidhje me zonën e mbrojtur të Kanionit Drini i Bardh, këto parcela nuk përfshihen ne atë vendim dhe nuk janë ne mbrojtje te asaj zone. Sa I përket këto parcela janë afër lumit Drini dhe njerëzit atje aty kanë gjetur hapësira te punueshme ka mundësi pasi që nëse e ka pasur afër pronës se vet edhe e ka punu por nuk problem pronësore atje.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë e qesim ne votim pikën e nëntë te rendit te ditës. Me shumicë te votave kalon për kuvend edhe pika e nëntë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e dhjetë te rendit te ditës:

10. Shqyrtimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale për Bujqësi.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, kolegë drejtor, anëtarë te KPF-së. Për shkak te ekonomizimit te kohës, e kemi paraparë që pronat që i kanë kërkuar për marrjen ne shfrytëzim prona për marrjen ne destinim bujqësor dhe pronat për destinim blegtoral i kemi përfshije ne një propozim. Pra ne pikën e dhjetë i keni shtatë parcela që dallojnë në zona dhe ne sipërfaqe por ne mbledhje te kuvendit pasi që kalon ne KPF këna me kerku secilën veç e veç dhe do te votohet për secilën parcelë veç e veç që te krijohen vendime pasi që dallojnë kërkesat e qytetareve që janë drejtuar për ne që kanë kërkuar me qira pasi dallojnë sipërfaqe dhe ne zona dhe do ti fusim në mbledhje te kuvendit veç e veç. Por tash për mos me ngarkuar rendin e ditës edhe ashtu janë 17 pika edhe këto për bujqësi edhe ato që do te vijnë me vonë për blegtori i kemi përfshije ne një propozim. Sipas ligjeve te aplikueshme para jush keni materialin me propozim vendim te kryetarit te komunës për miratim paraprak për dhënien e pronës se paluajtshme te komunës ne shfrytëzim personave fizik dhe juridik. Kështu që po kërkojmë prej juve që këto prona te marrim vendim që me ju dhanë me qira për kohen prej 15 vite. Pas secilës pikë pas pikës 2 deri te pika 2.7 për secilën parcelë keni certifikatën e pronës, për secilën parcelë që po propozohet për me u dhanë me qira e keni kopjen e planit dhe për secilën parcelë e keni nga një ortofoto që për shkaqe teknike nuk kemi pasur mundësi me i prezantu ne projektor por ne seancën e kuvendit do te kujdesemi që të jenë edhe me ngjyrë. Po vazhdojmë me pikën 2, pronat e paluajtshme për dhënien ne shfrytëzim te pronës, pra bëhet fjalë për parcelën me Nr. 0054-0 ne zonë kadastrale në Hoçë te Madhe me sipërfaqe 2 ari 56 m2 kjo është ne komunën e Rahovecit, pastaj 00265-0 ne zonë kadastrale ne Hoç të Madhe me sipërfaqe 8 ari 55m2, parcela 00498-0 ne zonë kadastrale ne Xerxe me sipërfaqe 44 ari 87 m2 që është pronë e komunës se Rahovecit, pastaj parcela 02909-0 në zonë kadastrale e cila gjendet ne Rahovec me sipërfaqe prej 45 ari 10 m2 që është pronë e komunës se Rahovecit, parcela 03015-0 që është ne zonë kadastrale ne Rahovec me sipërfaqe 2 ari 90 m2 që është pronë e komunës se Rahovecit , parcela 03016-0 që gjendet ne zonë kadastrale ne Rahovec me sipërfaqe 6 ari 50 m2 që është pronë e komunës se Rahovecit, parcela 00251-0 ne zonë kadastrale ne Çifllak, kjo parcelë është shume e madhe mirëpo ne e kemi shtie ne material një skicë që kërkuesi po kërkon prej kësaj sipërfaqe pjesë te parcelës d.m.th. është e specifikuar edhe ne propozim vendim pasi që është parcelë shume e madhe dhe është pronë e komunës se Rahovecit dhe po kërkon 100,000 m2 që me i marr ne shfrytëzim. Drejtoritë përkatëse pranojnë kërkesa vazhdimisht për me i marr këto prona me qira, neve anëtareve te KPF-së nuk guxojmë me ja bashkëngjit kërkesat sepse sipas ligjit ne fuqi fillimisht merret vendimi ne kuvend dhe është e drejta e juaj që me i dhanë 1-15 vite pastaj këto materiale shkojnë ne

drejtorinë e ekonomisë dhe me pastaj drejtoria e ekonomisë organizon ankand publik e aty kanë të drejt me aplikua për këto parcela brenda 30 ditëve të gjithë qytetaret e komunës së Rahovecit sipas rregullores për taksa dhe tarifa, janë çmimet kush jep ma shume edhe i fiton pasi është komisioni që merret me vlerësimin e tyre. Neve nuk guxojmë me i prezantua pasi jo gjithmonë kërkuesi edhe fiton në ankand publik pasi kush paguan me shume edhe i merr. Kështu që ju ftoj që pas shqyrtimit të votoni propozim vendimin për marrjen e pronës me qira.

Burim Krasniqi – Pa deshtë me kërkuar emra janë disa parcela të vogla që shihen që janë në shfrytëzim. A mundemi me pas si informacion qëllimin e destinimit pasi a do të lejohet për ndërtim, stallë apo për me mbjellë diçka aty, që me pas material plotësues që kur ta japim në shfrytëzim me ditë se për çka po e japim, pasi që edhe që nuk është sipërfaqe e madhe mund të jetë edhe për mbjellje por kjo 256 m² është e palogjikshme me pretendua me pas mbjellje diçka pasi është pak me shume se 2 ari.

Afrim Oruqi – Krejt këto parcela që i kaluam tash janë të destinuara për qëllime bujqësore pasi nuk ka ndërtim pasi e kanë të ndaluar me kontratë e specifikuar dhe nuk ka stalla. Kështu që janë vendime tjera kur i bëm për stalla e kërkojmë miratimin e juaj për blegtori. Në këto parcela që janë për destinim bujqësor e kanë të ndaluar me ndertu. Dhe këto parcela të vogla janë në kufij njëra me tjetrën pasi këto parcela gjinden në Sejan dhe pronari që e ka token aktualisht ngjitet me këtë parcelë është duke e punuar parcelën e vet dhe e ka kufij këtë dhe po kërkon me i marr me qira pasi i ka në kufij me parcelën e vet. Zakonisht që ndodh edhe merret vendimi edhe nuk ka të interesuar kështu që prapë mbesin dhe nuk merren me qira.

Kryesuesi – Atëherë e qesim në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës. Me shumicë të votave kalon për kuvend edhe pika e dhjetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P – 00054-0, P-00265-0, P- 00498-0, P – 02909-0, P-03015-0, P-03016-0, P – 00251-0.

Afrim Oruqi – Në mandatin e kaluar e kemi formuar një komision dhe ashtu ka qenë e paraparë me ligj dhe ky komision ka shqyrtuar kërkesat brenda 4 viteve. Kurse tash po kërkohet që për çdo parcelë sa herë që sjellim parcela në kuvend me i dhanë me qira qoftë për bujqësi apo blegtori duhet me formua komisionin, ku fillimisht komisionin për me i shqyrtuar kërkesat me i hap ofertat por edhe të njëjtën kohë kemi me formou komisionin në çdo seancë për ankesa të mundshme që mundemi me pas. Kështu që në seancën e radhës kanë me u dhanë propozime, kështu që kërkojmë nga ju tani me dhanë miratimin për me kalu në kuvend, vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për krejt këto parcela që i lexuam me herët.

Burim Krasniqi – Komisioni është i përcaktuar prej 5 anëtareve apo mundet të jetë edhe me shume, pasi e kam në kontestin e asaj që me muajt me pas përfaqësues të gjithë grupeve të asamblistëve me pas nga një anëtar në këtë komision përveç dy që janë nga ekzekutivi dhe i OJQ-së. Pra që mos me ardhë të votimi formal i komisioneve në asamble por me pas një konsensus që secili me pas nga një emër dhe shkohet tutje.

Afrim Oruqi – Këto janë të parapara numri i anëtareve që vijnë nga ekzekutivi dhe nga kuvendi dhe një përfaqësues vjen nga sektori jo qeveritar. Saktësisht këto udhëtime dhe këto ligje e përcaktojnë edhe numrin e anëtareve e përfaqësuesve në këto komisione.

Kryesuesi – Atëherë e qesim në votim edhe pikën njëmbëdhjetë të rendit të ditës. Me shumicë të votave aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për blegtori.

Afrim Oruqi – TË nderuar anëtar te KPF-së, para jush keni materialin, pasi me herët kemi marr vendim për me dergu ne kuvend propozimin për dhënien e pronave me qira për destinim bujqësor kurse tash kemi të bëjmë me parcela që i kanë kerku njerëzit për me ndërtua stalla ne nivel te komunës ku dallojnë ehe zonat. Propozimi i Komitetit për Politike dhe Financa që miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës se paluajtshme te komunës pasi krejt këto parcela janë prona te komunës ne shfrytëzim personal fizik dhe juridik ne afat prej 15 viteve. Në zhvillimin e procedura te ankandit publik për dhënin ne shfrytëzim afat shkurtër prej 1-15 vjet. Pronat e paluajtshme për dhënien ne shfrytëzim te cekur ne pikën 1 te këtij propozimi janë parcela me numër 02302-0 në zonën kadastrale ne Rahovec be vendin e quajtur Ravne shume me kulturë kullose te klasit te pestë me sipërfaqe te përgjithshme me hektar. Për këtë pikë para jush keni certifikatën e pronës e komunës, pastaj e kemi kopjen e planit gjithashtu edhe propozimin e përfaqësuesit, qe për njohurin e juaj është ne rrugën Rahovec –Drenoc ne anën e djathtë ku kemi ndërtuar një shteg aty që janë prona te privatizuar të Stone Castle që është bjeshk dhe propozuesi po kërkon që me marr ne shfrytëzim një pjesë te kësaj parcele me sipërfaqe te përgjithshme prej 1 hektar e 50m2. Propozimi i dytë i parcelës sipas certifikatës 00250-0 ne zonë kadastrale ne Çifllak ne vendin e quajtur Ravne shume me kulturë kullorë e klasit te pestë për blegtori dhe është bjeshkë me sipërfaqe te përgjithshme 91,939m2 dhe po kërkohet që te jepet ne shfrytëzim vetëm pjesa e parcelës, pasi propozuesi ka kerku që me marr prej kësaj sipërfaqe ne shfrytëzim 12,000m2, e cila është pronë e komunës. Qëllimi i dhënies ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme te komunës ne pikën 1 dhe 2 te këtij propozimi është ruajtja dhe rritja e vlerës e pronës publike komunale për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë e gjithashtu edhe dhënia e mundësive te qytetareve te vetëpunësohen. Ky paragraf mundësi për kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë e pastaj ju jep te drejtë këtyre që i marrin ne shfrytëzim me ndertu edhe stalla. Afati kohor për dhënien për dhënien e pronës se paluajtshme ne shfrytëzim sipas pikës 1 dhe 2 te këtij propozimi është në afat prej 15 vjet. Kërkoj që pas shqyrtimit te votohet propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim.

Burim Krasniqi – Pika 2.1 është 199,774m2 komplet sipërfaqja dhe ju thatë se ka kërkuar me pak mirëpo nuk është e potencuar që ka kërkuar me pak. Sa e shoh unë te prona e paluajtshme për dhënien ne shfrytëzim te cekur ne pikën 1, pasi te pika 2.2 është ne rregull mirëpo te pika 2.1 a e ka kërkuar komplet apo e ka kërkuar vetëm një pjesë te pjesës se përgjithshme.

Afrim Oruqi - Këtu ne material e keni skicën e terrenit që është e punuar sipas gjeodeteve sipas kërkesës se palës ku kjo është tërësia dhe pjesa katror është e specifikuar pjesa e parcelës ku pjesa e përgjithshme është 2302-0 numri i parcelës ndërsa pronari ka kërkuar një sipërfaqe s=01,50 ari d.m.th. ky ka kërkuar prej sipërfaqes se përgjithshme ka kërkuar 1 hektar e 50 ari d.m.th. skica është edhe për 1 edhe për 2.

Burim Krasniqi – Te përshkrimi tekstual te propozim vendimi pika 2.1 nuk e përshkruan sipërfaqen që është kërkuar për shfrytëzim kurse pika 2.2 e përshkruan qartë që prej 91,000 i kërkon 12,000m2. Keshtu që veç po them se është gabim teknik te përshkrimi te propozim vendimi që kur te vjen ne seancën e rregullt te vjen me përshkrimin nga sipërfaqe prej 199,774m2 është kërkuar ne shfrytëzim sipërfaqja e caktuar me m2.

Afrim Oruqi – Besoj që kjo është gabim teknik dhe do ta përmirësojmë se bashke me zyrën e kuvendit dhe e specifikojmë ne këtë paragrafin.

Kryesuesi – Atëherë e qesim ne votim këtë pike te rendit te ditës bashke me rekomandimin e Burim Krasniqit. Konstatoj se me shumicë te votave kalon për kuvend edhe pika e dymbëdhjetë e rendit te ditës. Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë te rendit te ditës:

13. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme te Komunës P – 02302-0 dhe P – 00250-0.

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtar te KPF-së, si me herët që morëm miratimin e komisionit për formimin e komisionit për me i dhanë me qira tokat që kanë të bëjnë me destinim bujqësor, tash po kërkojmë prej juve miratimin për me formua komision për me i dhanë këto toka tjera që kanë të bëjnë qëllimin për destinim për blegtori. Procedura është e njëjte dhe emrat jepen në mbledhjen e kuvendit. Ftojë anëtarët e KPF-së që të miratojnë propozimin për themelimin e komisionit për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për të gjitha ato parcela që folëm me herët.

Kryesuesi - Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar për këtë pikë të rendit të ditës, e qesim në votim. Me shumicë të votave kalon për kuvend edhe pika e trembëdhjete e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katëmbëdhjetë të rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P – 71513005-02756-0 në Zonën kadastrale në Krushe të Madhe.

Erhan Morina – I nderuar kryesues, nënkryetar, drejtor të drejtorive, anëtar të komitetit për Politike dhe Financa. Para jush kemi materialin shpallje me interes të përgjithshëm publik të parcelës 02756-0 në zonën kadastrale në Krushe të Madhe e cila ka sipërfaqe 187,647m². Kjo parcelë gjendet në Krushe të Madhe në zonën e quajtur Paca, ku sipas pronës së certifikatës është në posedim të agjencionit të ujërave. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë caktimi i lokacionit për hapësira për biznese njëjt sikur në pikën e mëhershme të cilat do të shërbejnë për zhvillimin e bizneseve në komunën e Rahovecit. Kështu që kërkoj nga ju që ta miratoni këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim. Me shumicë të votave aprovohet edhe pika e katëmbëdhjetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pesëmbëdhjete të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P – 71510033-00527-1 në Zonën Kadastrale në Xërxë.

Afrim Oruqi – Para jush kemi propozimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën 00527-1 e cila gjendet në zonën kadastrale në Xërxë në aksin rrugor Rahovec – Xërxë në anën e djathtë përball M-Silos. Kryetari i Komunës, komitetit për Politike dhe Financa po i propozon iniciimin e procedurës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës P- 00527-1 e cila është në zonën kadastrale në Xërxë me sipërfaqe prej 11 ari e 43 m². Pronar i kësaj parcele është pronë shtetërore e Kosovës KK-Rahovec, shfrytëzues NBI-Rahoveci që aktualisht menaxhohet prej AKP-së. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës sipas këtij propozimi do të jetë ndërtimi i objektit për magazinimin të produkteve bujqësore në atë zonë dhe drejtorja e gjeodezisë do të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi. Ftojë anëtarët KPF-së që të miratojnë propozimin e vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik.

Kryesuesi – Atëherë e qesim në votim këtë pikë. Me shumicë të votave aprovohet pika e 15-të e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës:

16. Shqyrtimi Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P – 7151000033-00527-2 në Zonën Kadastrale në Xërxë.

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtarë të KPF-së, këto dy parcela në zonën e njëjtë janë përball njeri tjetrit përball M-Silos, behet fjalë për sipërfaqe 5 ari 3m², gjithashtu pronë shtetërore e Kosovës KK-Rahovec, shfrytëzues NBI-Rahovec dhe menaxhohet prej AKP-së. Mirëpo në këtë rast dallon qëllimi, pasi me herët ishte me ndërtua një objekt për konservimin produkteve bujqësore kurse të kjo pikë qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik ka të bëjë me parcelën e cekur në pikën 1 dhe qëllimi është hapja e rrugës publike. Këto parcela i kemi në ortofoto dhe planin e kemi material të bashkangjitur dhe janë parcela të

ngushta te gjata ne Xërxe edhe ashtu kjo parcelë po shfrytëzohet për rrugë e cila është e kalueshme dhe fushore që e shfrytëzojnë banoret e atij lokacioni. Bartës për rregullimin e dokumentacionit do te jetë drejtoria e gjeodezisë dhe kërkoj nga ju që pas shqyrtimit te votoni propozimin për me kalua ne kuvend.

Besë Bytyqi – Faleminderit kryesues, realisht nuk kam diçka te rëndësishme me shtu por po dua me falënderua drejtorin Afrim Oruqi për gatishmërinë edhe për krejt informacionet pasi e dimë që me se shumti pika ka pikërisht kjo drejtori.

Burim Krasniqi – Te pika e 15-të a ka ndonjë kërkesë prej ndonjë biznesi për me marr ne shfrytëzim për ndonjë natyrë biznesi apo do te jet ndonjë investim i komunës që kur te shpallet i përgjithshëm e ku mundet me bo investimin sikur qysh është paraparë te pjesa e tregut te rrushit për me ndertu frigoriferin apo diçka te ngjashme. Pra a është kërkesë e ndonjë biznesi apo e ndonjë qytetari për investim apo po e bën komuna që nesër me bo investimin si komunë.

Afrim Oruqi – Nuk ka kërkesë specifike për këtë por ne vetëm po mundohemi me i zbatu procedurat e ligjit dhe fakti që menaxhohen prej AKP-së po mundohemi me i bo fillimisht prona te komunës për me pas pasi që kemi shume pak prona te komunës ne atë zonë për shkaqe te ndryshme para dhe pas luftës . Pra qëllimi është me i shpall me interes te përgjithshëm e pastaj ne një seancë tjetër te provojmë me bordin e AKP-së dhe qeverinë e Kosovës që me i marr këto prona ne menaxhim por nëse jo atëherë ne seanca tjera me i këmbye.

Kryesuesi – E qesim ne votim edhe pikën e 16-të te rendit te ditës. Me shumicë te votave aprovohet edhe pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit te ditës.

Kryesuesi – Kemi edhe tri pika tjera shitesë për mbledhje te kuvendit.

17.Raporti i vlerësimit për pronën e paluajtshme SHL-Kosova që u dhanë ne shfrytëzim dhe ne seancën e rregullt komisioni që ka bo vlerësimin e pronës do te raportoj ne kuvend.

18.Shqyrtimi i formimit te komisionit jo obligativ për arsim dhe Shqyrtimi i formimit te komisionit jo obligativ për shëndetësi

19.Të ndryshme.

Rumir Zhuniqi – Ndoshta do te ishte mirë sot me ja përcaktua edhe formatin se sa anëtar do ti ketë dhe cili do te jet roli që ne mbledhje te kuvendit me ardhë materiali edhe vetëm me i dhanë propozimet.

Kryesuesi – Unë po besoj që sekretaria e kuvendit bashkë me zyrën ligjore do te merret me çështje administrative dhe rregullimin e formatit te dy komiteteve. Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, konstatoj te mbyllur këtë mbledhje dhe shihemi ne seancën e radhës.

Mbledhja përfundoj në ora 11:30

Procesmbajtësi,

Agim Hoti


KRYESUESI
Deftim Kafexhiu